



VENDIME TË MIRATUARA NË MBLEDHJEN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE, DATË 1 GUSHT 2024

1 GUSHT 2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

V E N D I M

P Ë R

LEJIMIN E PËRDORIMIT TË BRIGJEVE DHE TË ZONËS PËRKATËSE TË PLAZHIT PËRBALLË KOMPLEKSIT, NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË PROJEKTIT INVESTUES STRATEGJIK "SAN PIETRO"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr.55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lejimin e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në funksion të realizimit të projektit investues strategjik "San Pietro", me subjektin "Concord Investment", sh.p.k., Lalëz, Bashkia Durrës, sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, i cili me vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike nr.25/2, datë 20.11.2017, "Për miratimin e statusit "Investim/investitor strategjik procedurë e veçantë", për projektin e investimit me potencial strategjik "San Pietro", dhe nr.25/5, datë 15.12.2020, "Për shtyrjen e afatit të statusit "Investim/investitor strategjik procedurë e veçantë" për projektin e investimit me potencial strategjik "San Pietro", të ndryshuar, ka përfutuar statusin "Investim/investitor strategjik procedurë e veçantë".
2. Afati për përdorimin e brigjeve dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, sipas këtij vendimi, është 30 (tridhjetë) vjet, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Investitori strategjik "Concord Investment", sh.p.k., me NUIS K81602049K, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, paraqet pranë Bashkisë Durrës kërkesën dhe dokumentacionin, si më poshtë vijon:
- Planvendosjen e sipërfaqes, për të cilën subjekti kërkon të lidhë kontratë me njësinë e vetëqeverisjes vendore;
 - Përshkrimin e aktivitetit që do të realizojë në sipërfaqen, për të cilën kërkon të lidhë kontratë.
4. Bashkia Durrës ka detyrimin që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së subjektit "Concord Investment", sh.p.k., me NUIS K81602049K, të lidhë kontratën për lejin e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në përputhje me sipërfaqet dhe destinacionin e kërkuar nga subjekti, sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të lejuara me vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike nr.25/2, datë 20.11.2017, "Për miratimin e statusit "Investim/investitor strategjik procedurë e veçantë" për projektin e investimit me potencial strategjik "San Pietro"" dhe nr.25/5, datë 15.12.2020, "Për shtyrjen e afatit të statusit "Investim/investitor strategjik procedurë e veçantë" për projektin e investimit me potencial strategjik "San Pietro"", të ndryshuar, dhe konfirmuar nga Bashkia Durrës.
5. Përdorimi i brigjeve dhe i zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit të kryhet përgjatë periudhës së sezonit veror, të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi për turizmin, përkundrejt pagesës së tarifës, në përputhje me tarifën e plazheve, të përcaktuar në vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës. Kjo tarifë aplikohet vetëm mbi sipërfaqen, objekt kontrate, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij vendimi, të lidhur me Bashkinë Durrës, përgjatë periudhës së përmendur në këtë pikë.
6. Të ardhurat e mbledhura nga tarifa për dhënien e së drejtës së përdorimit të brigjeve dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit derdhen në buxhetin e Bashkisë Durrës.
7. E drejta e përdorimit të brigjeve nga ana e investitorit strategjik, subjekti "Concord Investment", sh.p.k., me NUIS K81602049K, sipërfaqja e lejuar për përdorim afatgjatë dhe kushtet e përdorimit bazohen në vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike nr.25/2, datë 20.11.2017, "Për miratimin e statusit "Investim/investitor strategjik procedurë e veçantë" për projektin e investimit me potencial strategjik "San Pietro"", dhe nr.25/5, datë 15.12.2020, "Për shtyrjen e afatit të statusit "Investim/investitor strategjik procedurë e veçantë" për projektin e investimit me potencial strategjik "San Pietro"", të ndryshuar, dhe në përputhje me përcaktimet e kontratës përkatëse, që investitori strategjik duhet të lidhë me Bashkinë Durrës.
8. Ngarkohet Bashkia Durrës për lidhjen e kontratës përkatëse me investitorin strategjik, në zbatim të këtij vendimi, dhe të vendimeve të Komitetit të Investimeve Strategjike nr.25/2, datë 20.11.2017, "Për miratimin e statusit "Investim/investitor strategjik procedurë e veçantë" për projektin e investimit me potencial strategjik "San Pietro"", dhe nr.25/5, datë 15.12.2020, "Për shtyrjen e afatit të statusit "Investim/investitor strategjik procedurë e veçantë" për projektin e investimit me potencial strategjik "San Pietro"", të ndryshuar. Në këtë kontratë parashikohen shprehimisht të drejtat e detyrimet e autoritetit kontraktues dhe të drejtat e detyrimet e investitorit, në funksion të projektit të investimit strategjik, si dhe penalitetet përkatëse. Kontrata për dhënien me qira të përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, nën juridiksion të Bashkisë Durrës, ka afat për një periudhë 30-vjeçare, me kusht që investitori të mos ndryshojë destinacionin e pronës (përfshirë, por pa u kufizuar në ndërtimin, dhënien me qira palëve të treta).
9. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkia Durrës, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

V E N D I M